URDHËR
Nr.132, datë 8.3.2020

PËR MBYLLJEN E AKTIVITETEVE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ANULLIMIN E GRUMBULLIMEVE MASIVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA

(Ndryshuar me urdhrin nr. 222, datë 1.4.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërmat "b" dhe "c", të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri", si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike të tilla si aktivitete sportive, aktivitete kulturore dhe konferenca, *deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019*.
2. Anullimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura të tilla si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, *deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019*.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik dhe të gjithë strukturat përgjegjëse për organizimin e veprimtarive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCALE
Ogerta Manastirliu